

SKEDË TEKNIKE

RÖFIX UniContact

Ngjitës për pllaka izoluese dhe rrafshues.



Fushat e përdorimit

Ngjitës dhe rrafshues mineral për panelet izoluese të fasadave me polisterol (EPS-F) dhe panelet bazë të thatë (EPS-P/XPS-R). Për shtresa përforcuese me trashësi 3mm. (Trashësia specifike NPD) Duhet të respektohen standardet kombëtare.

Karakteristikat

- Përpunim i shpejtë ekonomik

Përpunimi



Të dhëna teknike

Numri i artikullit	26226
EAN	9003304262267
Paketimi	
Sasi për njësi	30 kg/Nj.
Njësi për paletë	48 Nj./Pal
Madhësia e kokrrizave	0-1,2 mm
Ngjyra	gri
Konsumi	rreth. 4,5 kg/m ² 2,9 kg/m ²
Udhëzime për përdorimin	Të dhënat mbi konsumin janë orientuese, ato varen shumë nga karakteristikat e bazamentit dhe nga teknika e aplikimit.
Njësia e kërkesës për ujë	rreth. 7,5 L/Nj.
Reaksioni ndaj zjarrit	A2-s1, d0 EN 13501-1
Forca në shtypje	15 N/mm ² (28 d)
Forca në përkulje	≥ 2,5 N/mm ²
Përcjellshmëria termike	0,61 W/mK për P=50% EN 1745:2002 (Vlera e tabelës) 0,66 W/mK für P=90% EN 1745:2002 (Vlera e tabelës)
Moduli-E	rreth. 9000 N/mm ²
Dendësia bruto	rreth. 1600 kg/m ³

RÖFIX UniContact

Ngjitës për pllaka izoluese dhe rrafshues.

Numri i artikullit	26226
Dëndësia në gjendje të papërpunuar	rreth. 1561 kg/m ³
Temperatura e nënshtresës	5-25 °C
Këshilla për paketimin	Në thasë letre me mbrojtje kundër lagështisë.

Baza e materialit

- Rërë e klasifikuar
- Çimento

Kushtet e punimit

Gjatë fazës së tharjes dhe përpunimit, temperatura e ambientit dhe bazamentit nuk duhet të bjerë nën +5 °C. Deri sa të arrihet tharja e plotë, mbrojeni nga ngrirja, tharja e shpejtë (rezatimi direkt i diellit, era) dhe shiu.

Bazamenti

Bazamenti duhet të jetë i thatë dhe i pastër, me aftësi mbajtëse si dhe pa papastërti si p.sh. pluhur, alga, blözë, kripra etj. .

Bazamenti-Trajtimi paraprak

Largoni lëndët ndarëse që formojnë shtresa filmi (vaj armature etj.). Sipërfaqet prej karbonat kalciumi ose rërë përforcini me RÖFIX fiksues ose largojini fare.

Përgatitja

Në aplikimin me dorë një thes përziheni sipas raportit me ujë të pastër duke përdorur një mikser ose përzierës mekanik derisa të arrini një masë homogjene. Koha e përzierjes në rast përzierje me dorë 2 deri 3 minuta. Pas përzierjes lëreni 10 min. në qetësi dhe pastaj përziheni përsëri.

Këshilla për përpunimin

Ngjitësi fortësohet dhe mund të mbajë ngarkesë pas 2 ditësh në temperaturë +15 °C dhe lagështi ajri 50 %. Llaçin e freskët punojeni brenda 2 orëve. Përpara vendosjes së tipllave, deri sa ngjitësi të forcohet plotësisht, pllakat izoluese, nuk lejohet të jenë nën ngarkesa të mëdha mekanike (psh. rrafshim, lëmim apo ngarkesa nga era). Materialin i hapur më parë nuk duhet përdorur, gjithashtu mos e përzieni me materialin e ri.

Përpunimi

Ngjitja e pllakave të termoizolimit: Shtrojeni llaçin ngjitës me metodën me pika - shirita (rreth 40% sipërfaqe ngjitjeje) gjerësia e shiritave rreth 5 cm, lartësia rreth 2 cm. Përforcimi i paneleve izoluese: Përafërsisht 2-3 ditë pas ngjitjes (nëse ngjitja është mjaftueshëm e fortë, në varësi të motit dhe kunjezimit) aplikoni llaçin perforcues në mënyrë të barabartë me mistrin e dhëmbëzuar RÖFIX në trashësinë minimale prej 3 mm të suvasë. Rrjeta përforcuese aplikohet brënda në shtratin e llaçit, mbivendoseni në zonën e bashkimit minimalisht 10 cm dhe rrafshojeni me mistri. Nëse është e nevojshme nivelojeni me mastar. Pas një kohe prehje prej 5-7 ditësh (sipas kushteve atmosferike - në kohë të ftohtë dhe me lageshtirë të gjatë) mund të aplikohet suvaja e sipërme e përshtatshme RÖFIX.

Magazinimi

Magazinojeni në vende të thata mundësisht mbi paleta druri. Koha e magazinimit: min. 12 muaj sipas. Rregullores 1907/2006/EG, Aneksi XVII, në temperaturë +20 °C, 65 % lagështi ambjenti.

ROFIX UniContact

Ngjitës për pllaka izoluese dhe rrafshues.

Udhëzime teknike dhe ligjore

Gjatë aplikimit të produkteve tona, respektoni të dhënat në skedat teknike, të cilat janë në përputhje me standardet e përgjithshme dhe specifike të vendit, si dhe të merren parasysh rekomandimet e shoqatës kombëtare të specialistëve.

Këshilla të përgjithshme

Kjo skedë teknike anullon dhe zëvendëson të gjitha versionet e mëparshme. Të dhënat e këtyre udhëzuesve teknike përkojnë me njohuritë dhe përvojën tonë praktike të deritanishme. Ky informacion dhe të dhënat janë përpiluar me kujdes dhe me ndërgjegje të plotë, por pa mbajtur përgjegjësi për vendime ose veprime plotësuese që mund të marrë vetë konsumatori. Të dhënat në vetevete nuk provojnë asnjë lidhje ligjore ose detyrime të tjera anësore, dhe normalisht nuk e ndalojnë konsumatorin të testojë produktin për ato qëllime për të cilat edhe është prodhuar. Produktet ROFIX si dhe të gjitha materialet përbërëse, i nënshtrohen një kontrolli të vazhdueshëm, me anë të të cilit garantohej një cilësi e pandryshueshme. Stafi ynë është i gatshëm tju japë cdo ndihmë teknike në lidhje me përdorimin, përpunimin si dhe mund të ofrojë edhe trajnime praktike në lidhje me përdorimin e produkteve tona. Skedat tona teknike më të reja, me të dhënat aktuale, mund ti gjeni edhe në faqen tonë të internetit (www.roefix.com), ose mund të kërkojnë edhe pranë filjaleve rajonale në vënd. Të gjitha të dhënat teknike të dhëna në këtë fletë produkti janë përcaktuar në kushte laboratorike.